



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur
dhe Peticione
Mbledhja nr.15
Prishtinë, më 8. 7. 2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujović, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim Rrustemi dhe Vezira Emrush - anëtarë

Të ftuar:

Elita Vokshi nga OSBE-ja dhe Rrahim Demaj nga stafi mbështetës i Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky

R e n d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të mbajtura më: 20. 06. 2008, 24. 06. 2008 dhe 1. 7. 2008,
3. Nxjerrja e konkluzioneve të dala nga dëgjimi publik mbajtur më 24. 06. 2008,
4. Shqyrtimi i peticioneve nr. 41/08, nr. 45/8 dhe nr. 57/8,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të mbajtura më: 20. 06. 2008, 24. 06. 2008 dhe 1. 7. 2008

Kryetari - Konstatoi se Komisioni i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 20. 06. 2008, 24. 06. 2008 dhe 1. 7. 2008.

3. Nxjerrja e konkluzioneve të dala nga dëgjimi publik mbajtur më 24. 06. 2008

Kryetari - Nënvizoi se dëgjimet publike e kanë efektin e vet, njëkohësisht i falënderoi mediat që ishin të pranishme dhe e vlerësoi lart kontributin e tyre. Lidhur me dëgjimin e mbajtur shtoi se kanë dalë disa kërkesa dhe propozoi të nxirren këto

P e r f u n d i m e

- Ishte konstatim i përgjithshëm i Komisionit se prokuroritë në punën lidhur me ngritjen e kallëzimeve penale kundër kryesve të krimeve, si dhe me procedimin e tyre, ishin jo azhure. U kërkua të jenë ma azhure.
- Kërkohet të ketë koordinim ndërmjet organeve gjyqësore dhe institucioneve shtetërore që kanë lidhshmëri me zgjidhjen e lëndëve.
- Kërkohet nga Komisioni të mbajë takim me institucionet e mëparshme që i kanë udhëhequr komisionet për personat e pagjetur dhe asociacionet përkatëse, me qëllim të grumbullimit të informatave lidhur me kallëzimet penale që kanë mbetur.
- U kërkua nga Ministria e Drejtësisë ta përshpejtojë procedimin e Projektligjit të Komisionit për Personat e Pagjetur.

Komisioni u pajtua për pikat e lartpërmendura dhe kërkoi jetësimin e tyre.

4 Shqyrtimi i peticioneve nr. 41/08, nr. 45/8 dhe nr. 57/8

Lidhur me këtë pikë, kryetari e ftoi raportuesen e peticioneve ta merrte fjalën dhe t'i njoftonte anëtarët për përmbajtjen e tyre.

Prof dr. Nerxhivane Dauti – vuri në pah se ka shqyrtua shkresën nr. 41/08 e datës 17. 03. 2008 e ushtruar nga 912 punëtorë të Fabrikës së Tubave të Çeliktë, që kanë ushtruar padi për anulimin e kontratës së shitblerjes së Fabrikës. Theksoi se veprimi i ndërmarrë për të cilin ka vendosur Gjykata Komunale me aktgjykimin nr. 469/2005 dhe e ka vërtetuar Gjykata e Qarkut si dhe Gjykata Supreme - Dhoma e Posaçme, është i kundërligjshëm. Ajo u rekomandoi ushtruesve të peticionit që t'i drejtohen Gjykatës Komunale të Ferizajt për zbatimin e aktgjykimit të plotfuqishëm.

Shkresa nr. 57/08 e datës 13.5. 2007, e ushtruar nga Ali Nura , që ka të bëjë me regjistrimin e truallit rekomandon t'i drejtohen gjykatës kompetente si institucion i vetëm legjitim për të marrë vendim të tillë.

Shkresa nr. 03-0068 e datës 31. 1. 2008, e banorëve të fshatit Lajthishtë nga Obiliqi, me të cilën kërkohet nga institucionet e Republikës së Kosovës të marrin masa për përmirësimin e

mirëqenies se tyre. Për zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe për ngritjen e infrastrukturës, Komisioni rekomandon që t'i drejtohen Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe të kërkojnë nga Qeveria të marrë masa për plotësimin kushteve.

Drita Maliqi - Duke u ndërlidhur me petitionin i propozoi Komisionit ta vizitojë fshatin dhe të njihet më për së afërmi me problemet e tyre. Propozimi i saj u mirëprit. Të pranishmit u pajtuan që për t'u realizuar kjo vizitë të përfshihet ne planin e punës.

5. Të ndryshme

Kryetari e ngriti çështjen e financimit të komisioneve, kërkoi që ato ta kenë vijën buxhetore dhe të përfshihen në Rregulloren e punës së Kuvendit. Kjo do të ndihmonte për vizitat studimore jashtë Kosovës.

Sanije Alijaj – Duke u ndërlidhur me diskutimin kërkoi një vizitë jashtë Kosovës. Pasi ceku se shumica e tyre po i realizojnë vizitat, një gjë të tillë e kërkoi me shkrim nga Kryesia e Kuvendit.

Ibrahim Makolli - Kërkoi nga Komisioni që t'i vizitojë grevistët e RTP-së. Ky propozim u mirëprit nga kryetari dhe nga të tjerët.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

Përgatitur nga
Rrahim Demaj, zyrtar i lartë ligjor

Kryesuesi i Komisionit
Ismet Beqiri